



Partnerët - Shqipëri, Qendra për
Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti

Raport Aktivitetesh

Qershor 2001 - Korrik 2004



Partnerët - Shqipëri, Qendra për
Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti

Raport Aktivitetesh

Qershor 2001 - Korrik 2004



Botimi i këtij raporti u bë i mundur nëpërmjet mbështetjes së
Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

TABELA E PERMBAJTJES

HYRJE	3
MISIONI DHE HISTORIA	4
STRATEGJIA 2001 – 2004 E PARTNEREVE-SHQIPERI	6
PROGRAMET E PARTNEREVE-SHQIPERI:	7
I. FUQIZIMI I SEKTORIT TE OJF-VE	7
A. Vlerësimi i Nevojave të OJF-ve, 2001	
B. Programi i Trainimit dhe Asistencës Teknike për Sektorin e OJF	
C. Programi i Granteve të Vogla	
II. FORCIMI I KAPACITETEVE TE PUSHTETIT VENDOR	13
III. FUQIZIMI I LIDERSHIPIT DHE AFTESIVE BASHKEPUNUESE TE QYTETAREVE SHQIPTARE	15
A. Zhvillimi i Lidershipit të Gruas	
B. Zhvillimi i Lidershipit të Rinisë	
C. Programi Akademik	
D. Iniciativat e Planifikimit Kooperues	
IV. INICIATIVA TE TJERA	18
A. Iniciativa e Kuadrit Ligjor për OJF-të	
B. Qeverisje e Mirë	
STRATEGJIA E QENDRUESHMERISE SE PARTNEREVE – SHQIPERI	20
ANALIZA FINANCIARE E TE ARDHURAVE TE PARTNEREVE-SHQIPERI	21
BASHKEPUNETORET DHE KONTRAKTUESIT E PARTNEREVE - SHQIPERI	22
DEKLARATA TE BURIMEVE TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIT TE FONDEVE	25
PARTNERET – SHQIPERI, PERFITUESIT E GRANTEVE TE VOGLA (Shtojcë)	28

Ky raport vjen tek ju si një përpjekje e Partnerëve – Shqipëri për të pasqyruar rezultatet dhe impaktin e aktiviteteve të saj në tre vitet e para të funksionimit të Qendrës. Në këto tre vjet nëpërmjet kanaleve të ndryshme, Partnerët – Shqipëri ka komunikuar rregullisht mbi aktivitetet, rezultatet dhe planet e së ardhmes. Me anë të këtij raporti ne dëshirojmë t'ju japim një pamje më konçize dhe analitike të misionit, strategjisë, programeve dhe aktiviteteve të Partnerët – Shqipëri.

Megjithëse një anëtare e re e sektorit, Partnerët – Shqipëri është krenare për investimin e saj solid në zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri. Përpjekjet tona (Partnerët – Shqipëri) kanë kontribuar në drejtim të një sektori OJF-sh më transparent, të qëndrueshëm dhe vital; në sigurimin e shërbimeve të ndryshme sociale për komunitetet në nevojë; një bashkëpunimi më të fuqishëm ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor në përpjekjet e tyre për një qeverisje më efektive dhe transparente dhe shërbime më të mira ndaj publikut; për përfshirjen aktive dhe të përgjegjshme të qytetarëve në zhvillimin e komunitetit. Në tre vitet e kaluara, Partnerët – Shqipëri është bërë një partner dhe ofrues shërbimesh i besueshëm për shumë organizata lokale dhe ndërkombëtare në Shqipëri.

Me këtë rast, do të dëshiroja të falenderoja stafin e Partnerëve – Shqipëri, të cilët kanë investuar kaq shumë në ndërtimin e një organizate të qëndrueshme e me reputacion; donatorët dhe mbështetësit tanë, të cilët kanë besuar dhe vlerësuar shërbimet dhe ekspertizën tonë; si dhe bashkëpunëtorët tanë, të cilët na kanë asistuar në përballimin e sfidave tona të rritjes si organizatë.

Me këtë tre-vjecar të lënë pas, ne qëndrojmë të vendosur për të vazhduar punën tonë të dedikuar në drejtim të ndërtimit të një shoqërie të qëndrueshme dhe demokratike në Shqipëri.

Juliana Hoxha
Drejtore e Qendrës

PARTNERËT-SHQIPËRI, QENDRA PËR NDRYSHIM DHE MANAXHIM KONFLIKTI

Misioni dhe Historia

Partnerët-Shqipëri (PSh), Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti është një OJF shqiptare e pavarur me mision zhvillimin e shoqërisë civile, dhe kulturës së ndryshimit e manaxhimit të konfliktit në Shqipëri.

Partnerët-Shqipëri është rregjistruar në Tiranë në Gjykatën e Rrethit më 17 Prill 2001.

Partnerët-Shqipëri është themeluar në bashkëpunim me Partnerët për Ndryshim Demokratik (Partnerët), një organizatë ndërkombëtare me qendër në Shtetet e Bashkuara me synim për të ndërtuar kapacitete të qëndrueshme lokale për të zhvilluar shoqërinë civile dhe një kulturë ndryshimi dhe manaxhim konflikti në tërë botën. Partnerët Shqipëri është anëtare e Partnerëve Ndërkombëtarë për Ndryshim Demokratik (PNND), një rrjet i Partnerëve dhe Qendrave të tyre në 11 vende, të cilat ofrojnë trainime mbi zgjidhjen dhe manaxhimin e konfliktit dhe shërbime për komunitetin, OJF-të, pushtetin vendor dhe qendror, dhe sektorin e biznesit dhe medias në vendet e tyre dhe tërë botën.

Antarët e PNND i bashkon një mision dhe vlera të përbashkëta të ndryshimit demokratik dhe punojnë për të ngritur kapacite, bashkëpunim, dhe qëndrueshmëri ndërmjet antarëve të tyre. Nëpërmjet PNND, Partnerët zhvillojnë dhe forcojnë Qendrat përmes transferimit të ekspertizës dhe burimeve ndërmjet tyre, dhe duke angazhuar trainerë me eksperiencë nga Qendrat ekzistuese për të ngritur kapacitete trajnuese, aplikuese dhe të zhvillimit organizativ të Qendrave të reja.

Për më shumë informacion rreth Partnerëve-Shqipëri dhe Partnerëve Ndërkombëtarë për Ndryshim Demokratik, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit **www.partnersalbania.org** dhe **www.partnersglobal.org**.

PARTNERËT-SHQIPËRI, QENDRA PËR NDRYSHIM DHE MANAXHIM KONFLIKTI

Bordi i Drejtorëve i Partnerëve-Shqipëri

Brad Heckman	Ish - Drejtor, Sektori Ndërkombëtar, Partnerët për Ndryshim Demokratik - Themelues
Alban Eftimi	Drejtor i Departamentit të Politikave Urbane, Bashkia Tiranë
Ana Gjokutaj	Oficere e Mardhënieve me Publikun, Banka Botërore
Artan Hoxha	Gjykatës, Gjykata e Lartë e Shqipërisë
Artur Zheji	Gazetar, Drejtor i Televizionit Publik Shqiptar
Floresha Dado	Pedagoge në Fakultetin e Historisë – Filologjisë, Universiteti i Tiranës
Marieta Mima	Drejtoreshë e Qendrës Mjedisore për Administrim dhe Teknologji

Stafi i Partnerëve-Shqipëri

Juliana Hoxha	Drejtoreshë
Liliana Dango	Financiere
Elira Jorgoni	Manaxhere Programi
Suzana Liko	Trainere/ Manaxhere Programi
Jonida Alite	Trainere/ Manaxhere Programi
Elona Muça	Manaxhere e Granteve të Vogla
Elona Kapexhiu	Manaxhere Zyre / Kashiëre
Arben Musaka	Shofer

Rrjeti i Trajnerëve të Partnerëve-Shqipëri

Partnerët – Shqipëri ka krijuar partneritete me trajnerë nga organizata të tjera, të cilët ofrojnë shërbime dhe ekspertizën e tyre në programe të ndryshme të koordinuara nga PSh.

Aurel Jupe	SNV Fier
Eltin Qerazi	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
Julian Cani	Shoqata Shqiptare e Bashkive
Roland Lami	Agjencia e Zhvillimit Rajonal - Tiranë
Irena Bogdani	Pedagoge në Fakultetin Ekonomik
Mimoza Kasimati	Pedagoge në Fakultetin Ekonomik
Arbian Mazniku	Shoqata Shqiptare e Debatit Studentor
Klotilda Ferhati	Shoqata Shqiptare e Debatit Studentor

STRATEGJIA 2001 – 2004 E PARTNERËVE SHQIPËRI

Strategjia 3-vjeçare e Partnerëve Shqipëri është fokusuar në zhvillimin e demokracisë dhe shoqërisë civile në Shqipëri nëpërmjet forcimit të kapaciteteve institucionale dhe individuale, si dhe duke mundësuar bashkëpunimin efektiv në nivel ndër sektorial, ndërmjet sektorit të OJF-ve, pushtetit vendor dhe grupeve të tjera akademike dhe sociale.

Tre shtyllat e qëllimit të përgjithshëm të punës dhe strategjisë në vend janë:

I. MBESHTETJA E OJF-VE

Forcimi i vitalitetit të sektorit të OJF-ve në Shqipëri për t'iu përgjigjur më efektivisht nevojave të ndryshme sociale për zhvillim në tërë vendin.

II. FORCIMI I KAPACITETEVE TE PUSHTETIT VENDOR

Fuqizimi i roleve të pushtetit vendor për të manaxhuar më mirë sfidat e decentralizimit dhe përfshirjen efektive të qytetarëve.

III. LIDERSHIPI DHE BASHKËPUNIMI

Zgjerimi i pjesëmarrjes të qytetarëve shqiptarë nëpërmjet zhvillimit të aftësive drejtuese dhe promovimit të modeleve bashkëpunuese.

Objektivat e mësipërm janë arrirë nëpërmjet trainimeve të specializuara, sigurimit të asistencës teknike dhe mbështetjes financiare.

I. FUQIZIMI I SEKTORIT TE OJF-VE

Sektori shqiptar i OJF-ve ka hedhur hapa serioz drejt qëndrueshmërisë, ashtu siç vlerësohet edhe në Indeksin e Qëndrueshmërisë së Sektorit të OJF-ve¹ të USAID si dhe nga drejtues të OJF-ve prej fushave të ndryshme të zhvillimit. Sidoqoftë ka akoma vend për zhvillimin e sektorit të OJF-ve, sidomos në fushën e rritjes së aftësive të tyre në vlerësimin e nevojave të përfituesve dhe hartimin e shërbimeve.

Në mënyrë që të adresojë këto nevoja të shumta dhe divergjente në sektorin e tretë, Partnerët Shqipëri hartoi një program i cili synon të mbushë "boshllëqet aktuale të aftësive trajnuese" nëpërmjet:

- fuqizimit të OJF-ve për të punuar në nivel ndërsektorial si dhe në fusha profesionale,
- sigurimit të informacionit dhe trainimit mbi ligjin e ri të OJF-ve,
- dhe manaxhimit të granteve të vogla për të injektuar financime dhe energji në sektor.

A. Vlerësimi i Nevojave të OJF-ve, 2001

Partnerët-Shqipëri filloi punën e saj në fushën e forcimit të kapaciteteve të OJF-ve nëpërmjet hartimit dhe kryerjes së një sondazhi kombëtar që përfshinte OJF aktive lokale të cilat ofronin shërbime për publikun shqiptar. Sondazhi kishte për qëllim të vlerësonte nevojat e ndryshme për kapacitete institucionale, burimet e disponueshme financiare dhe institucionale si dhe kufizimet në këtë drejtim, përpjekjet për bashkëpunim brenda sektorit të OJF-ve dhe sektorëve të tjerë si pushteti vendor dhe qëndror, biznesi dhe media.

130 OJF nga tërë vendi morën pjesë në vlerësim. Ato përfaqësonin disa nën-sektorë duke përfshirë: demokracinë, shërbimet sociale/shëndetin, arsimin/kulturën, gratë, të rinjtë, mjedisin dhe biznesin. Ky vlerësim shërbeu si bazë për të përpunuar strategjinë për trainime dhe asistencë teknike për fuqizimin e sektorit të OJF-ve.

Disa nga gjetjet kryesore nga Vlerësimi i Nevojave të OJF-ve:

- Numri i OJF-ve në Shqipëri është rritur në mënyrë të konsiderueshme qysh prej vitit 1991
- OJF-të operojnë mbi bazë projektesh
- OJF-të kanë rritur tipet e projekteve për ofrim shërbimesh
- Sektori i OJF-ve mbetet i varur në masë të madhe nga donatorët
- Struktura e OJF-ve dhe ndarja e përgjegjësisë janë shpesh të paqarta dhe në disa raste karakterizohen nga konflikt interesash
- Sektori i biznesit nuk është një kontribues domethënës për qëndrueshmërinë financiare të OJF-ve
- Sektori i OJF-ve në përgjithësi vuan nga mungesa e besimit dhe besueshmërisë në publik dhe media

1) http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/2003/albania.pdf

- Bashkëpunimi ndërmjet OJF-ve mbetet ende një sfidë për shkak të vështirësive në ndarjen e përgjegjësive, mungesës së kapaciteteve në ngritjen e strukturave, dhe ndarjes së informacionit

Ky vlerësim u pasua me publikimin e një raporti gjithëpërfshirës mbi **Vlerësimin e Nevojave të OJF-ve**, në shqip dhe anglisht, si dhe krijimin e një baze të dhënash për sektorin e OJF-ve.

B. Programi i Trainimit dhe Asistencës Teknike për Sektorin e OJF

Bazuar në nevojat e identifikuara, Partnerët-Shqipëri zhvilloi *Programin e Trainimit dhe Asistencës Teknike për OJF-të* hartuar për të fuqizuar sektorin shqiptar jo-fitimprurës në aftësitë bazë që përfshijnë:

- manaxhim konflikti
- zhvillim organizativ
- marrjen në mbrojtje të politikave dhe ngritjen e koalicioneve.

Gjatë tri viteve të fundit, PSh ka zhvilluar dhe drejtuar një paketë të plotë modulesh trainimi për OJF të ndryshme. Trainimet janë ndërtuar sipas nevojave dhe kërkesave të organizatave dhe individëve. Hartimi i tyre përfshin vlerësimin e nevojave dhe diskutimeve të pritshmërive, përshtatjen e programit dhe ndjekjen e planit të trainimit. Trainimet janë hartuar në formën e kurseve interaktive që përfshijnë ushtrime praktike, raste studimore, materiale të printuara dhe informacione referuese.

Secili grup aftësish përfshin trainime të ndryshme të cilat janë të përshkruara më poshtë:

Aftësi të Zgjidhjes së Konfliktit

Meqenëse transmetimi i ideve tek publiku dhe qeveria është i rëndësishëm për aktivitetin e OJF-ve, Partnerët-Shqipëri organizon trainime për të rritur aftësitë e OJF-ve në prezantimin e këtyre çështjeve. Programet e Partnerëve-Shqipëri janë hartuar kryesisht për të plotësuar nevojat individuale të çdo organizate, duke përfshirë çështje të tilla si:

- Aftësi të komunikimit efektiv për drejtuesit e OJF-ve
- Aftësi në negociim dhe mediacion
- Aftësi në lehtësimin në mënyrë efektive të takimeve me publikun dhe qeverinë
- Aftësi të vendim-marrjes dhe planifikimit kooperues

Aftësi të Zhvillimit Organizativ

Meqenëse sektori i OJF-ve mbetet kryesisht i varur nga donatorët ndërkohë që fondet janë pakësuar, atij i duhet të përballet gjithmonë e më shumë me sfidat e organizimit dhe vetëfinancimit. Kështu që, OJF-ve iu kërkohet të kenë struktura të qëndrueshme organizative, plane të qarta strategjike, programe për sigurimin e të ardhurave ose programe për qëndrueshmëri, të jenë të besueshme në media dhe publik. Partnerët-Shqipëri ofron trainime dhe konsulencë për OJF-të në shumë fusha, përfshirë këtu:

- Hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e projektit
- Ndërtimin e ekipit brenda organizatës
- Manaxhimin financiar
- Proçedurat e brendshme organizative
- Zhvillimin e bordit
- Mardhëniet me publikun dhe prezantimi në media

PROGRAMET E PARTNERËVE SHQIPËRI

- Shkrimin e projekt-propozimit dhe sigurimin e fondeve
- Vetë-financimin e OJF- ve

Marrja në Mbrojtje e Politikave dhe Ndërtimi i Koalicioneve

Një nga pikat e fuqishme të komunitetit të OJF-ve varet nga niveli i përpjekjeve për bashkëpunim ndërmjet organizatave që kërkojnë të përmbushin një qëllim të përbashkët. Përfshirja e OJF-ve në hartimin e politikave dhe në ndërtimin e themeleve të demokracisë është e nevojshme për avancimin dhe demokratizimin e shoqërisë sonë. Disa nga aftësitë që ofron Partnerët-Shqipëri në këtë fushë janë:

- Krijimi i rrjeteve dhe shkëmbimi i informacionit brenda sektorit të OJF-ve dhe sektorëve të tjerë
- Ndërtimi i koalicioneve dhe mobilizimi i mbështetësve
- Sigurimi i mbështetjes së publikut nëpërmjet mediave
- Teknika të lobimit
- Shkëmbimi i informacionit dhe organizimi i seminareve dhe konferencave


Rezultatet e Programit të Trainimeve dhe Asistencës Teknike të OJF-ve

Shembuj përfaqësues të rezultateve të Programit të Trainimeve dhe Asistencës Teknike përfshijnë:

- 793 përfaqësues OJF-sh të trainuar në çështje të ndryshme të aftësive institucionale
- 70% e pjesëmarrësve në programin e trainimit të Zbatimit të Projektit kanë zhvilluar sisteme të reja monitorimi dhe vlerësimi
- 30% e pjesëmarrësve në programin e trainimit të Zbatimit të Projektit kanë përfituar një grant brenda 3-muajve pas marrjes së trainimit
- 50% e pjesëmarrësve në trainimin e Manaxhimit Financiar kanë përmirësuar transparencën organizative duke publikuar raportet vjetore financiare të organizatës
- 90% e pjesëmarrësve në trainimin Manaxhimi Financiar kanë përmirësuar sistemet e manaxhimit financiar duke rritur në këtë mënyrë efektivitetin dhe eficientësinë e përdorimit të fondit dhe duke rritur besimin tek donatorët dhe përfituesit
- 50% e pjesëmarrësve në trainimin e Hartimit të Proçedurave të Brendshme Organizative kanë zhvilluar proçedura që adresojnë konfliktin e interesave në organizatë.

Grafikët e mëposhtëm paraqesin një analizë të dhënash të temave të programeve të trainimit dhe përfituesve sipas disa treguesve, gjatë kohës së raportimit.

1. Trainimet e PSh kanë tërhequr pjesëmarrës nga të gjitha rajonet e Shqipërisë. Ndryshe nga shumë organizata trainuese, PSh ka tërhequr në mënyrë të suksesshme pjesëmarrës nga Shqipëria e Veriut (20%)



SHPËRNDARJA E OJF-VE PËRFITUESE TË TRAINIMIT
SIPAS ZONAVE GJEOGRAFIKE

C. Programi i Granteve të Vogla

Me qëllim forcimin e sektorit të tretë dhe rritjen e impaktit që OJF-të individuale kanë mbi komunitetet e tyre, Partnerët – Shqipëri koordinuan Programin e Granteve të Vogla.

Fondi i Grantit për Zhvillim Social i Partnerëve – Shqipëri/USAID synoi ndërtimin e kapaciteteve të OJF-ve shqiptare në fushën e ofrimit të shërbimeve për komunitetin. Totali i financimeve të programit të granteve ishte 873,932 USD. Objektivat specifike të Fondit të Grantit ishin:

- Mbështetje** për sigurimin e shërbimeve të nevojshme nga OJF-të në komunitetet shqiptare.
- Ndërtim** i kapaciteteve të OJF-ve shqiptare që ofrojnë shërbime për komunitetet e tyre.
- Inkurajim** i zhvillimit dhe shpërndarjes së shërbimeve që adresojnë nevojat më urgjente sociale, sidomos shërbime që fokusojnë grupet më të pambrojtur a në Shqipëri.

Programi i grantit u administrua nëpërmjet pesë raunde grantesh. Në total, PSh iu paraqitën rreth 360 projekt-propozime nga organizatat lokale. Gjatë tre viteve, PSh financoi 51-projekte nga të cilat kanë përfituar grupe të ndryshme sociale në tërë vendin². Projektet adresonin çështjet e anti-trafikimit dhe ofrimin e këshillimit psiko-social dhe strehimin e grave të abuzuara; takime të hapura me publikun, aktivitete edukative që përfshinin komunitetet lokale, pushtetin vendor dhe shkollat. Projekte të tjera adresonin punësimin, trainimin profesional, shëndetin dhe nevojat për arsimim midis grupeve të neglizhuara (grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara), iniciativa për hartim dhe zbatim ligjesh dhe zgjidhjen e konflikteve.

Strategjia e Partnerëve – Shqipëri në Manaxhimin e Granteve

Përpara dhënies së granteve, PSh ofroi konsultime dhe asistencë teknike individuale për më shumë se 100 OJF për hartimin e propozimit dhe zhvillimin e projektit. Më tej, PSh ka ofruar informacion dhe konsultime nëpërmjet takimeve publike për më shumë se 140 OJF si pjesë e programit të asistencës së granteve.

Partnerët – Shqipëri i ofroi trainime mbi manaxhimin e projektit dhe atë financiar, të gjithë përfituesve të granteve për t'i ndihmuar ata në manaxhimin efektiv të projekteve si dhe në përmbushjen e objektivave të tyre.

Disa shembuj të impaktit që programi i granteve të vogla të PSh ka patur në komunitet përfshijnë³:

- Fondacioni Shqiptar i Biznesit të Vogël mundësoi mbi 160 gra nga zonat rurale të marrin kredi dhe të fillojnë biznesin e tyre.
- Fondacioni Shqiptar për të Drejtën e Paaftësisë siguroi mjete lëvizëse dhe mundësi punësimi për më shumë se 90 persona me paaftësi nga zonat rurale dhe urbane të Shqipërisë.
- Nëpërmjet rrjetit të tij të vullnetarëve Shoqata për Kulturë Demokratike arriti të monitorojë në mënyrë të suksesshme të gjitha qendrat e votimit gjatë zgjedhjeve lokale të Tetorit 2003.
- Fondacioni Shqiptar për Zgjidhjen e Konflikteve hapi një qendër komunitare mediacioni në Malësinë e Madhe në Veri të Shqipërisë.
- Shoqata e Studuesve të Rinj të Shkencave Sociale dhe Instituti për Studime Sociale dhe Psikologjike arritën të prezantojnë në mënyrë të suksesshme punonjës social dhe psikologun si pjesë e ekipit pedagogjik në shkollën fillore dhe të mesme në Tiranë.

2) Për një listë të plotë të përfituesve të granteve të vogla, ju lutem referojuni shtojcës.

3) Më shumë informacion mbi impaktin e Programit të Granteve të Partnerëve për OJF-të shqiptare mund të gjendet në një raport të veçantë të publikuar nga Partnerët - Shqipëri

II. FORCIMI I KAPACITETEVE TE PUSHTETIT VENDOR

Autoritetet vendore në shoqëritë në tranzicion përballen me kërkesa në rritje për përgjegjshmëri më të lartë dhe përfshirje më të madhe të qytetarëve në procesin e decentralizimit. Në Janar të vitit 2000 qeveria shqiptare aprovoi "Strategjinë Kombëtare për Decentralizimin dhe Autonominë Vendore". Megjithëse procesi i decentralizimit ka bërë hapa përpara, kapaciteti i limituar i përfaqësuesve të pushtetit vendor për t'iu përgjigjur përgjegjësive në rritje si dhe për të marrë përsipër drejtimin dhe manaxhimin që kërkon një proces i tillë, përbën ende një pengesë.

Në tre vitet e fundit, Partnerët - Shqipëri ka punuar me nëpunësit e pushtetit vendor për të rritur aftësitë e tyre drejtuese dhe manaxhuese, si dhe për të rritur pjesëmarrjen qytetare në vendim-marrjen vendore. Këto programe theksojnë rëndësinë e ndërveprimit midis sektorëve e grupeve sociale (qytetarë, pushtet vendor dhe sektor privat) në adresimin e çështjeve të rëndësishme për komunitetin siç janë strehimi, papunësia, edukimi dhe shërbimet sociale.

Programet e Trainimit për Pushtetin Vendor

Partnerët - Shqipëri hartoi dhe zbatoi Programin e saj për Pushtetin Vendor si pjesë e strategjisë së saj tre vjecare të financuar nga USAID dhe Delegacioni i BE-së në Shqipëri. Më tej, Partnerët-Shqipëri ka marrë pjesë në programin rajonal "Forcimi i Demokracisë Vendore në Rajonin e Paktit të Stabilitetit" - një program rajonal për forcimin e kapaciteteve të pushtetit vendor për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Kosovën, Maqedoninë (Ish-Republika e Jugosllavisë), Malin e Zi, Rumaninë dhe Serbinë - një bashkëfinancim i Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Ministrisë Hollandeze të Punëve të Jashtme.

Deri tani Partnerët - Shqipëri ka zbatuar programet e mëposhtme për pushtetin vendor:

Rolet e Zyrtarëve të Zgjedhur

Programi konsistoi në një paketë prej 10 rolesh që duhet të luajnë zyrtarët e zgjedhur ose stafi i emëruar në pushtetin vendor. Një rëndësi të vecantë në program kishte ndërtimi i kapaciteteve trainuese brenda njësive vendore të zgjedhura. Nën këtë program PSh trainoi 100 nëpunës mbi Rolet e Zyrtarëve të Zgjedhur dhe 42 pjesëmarrës më aktiv u trajnuan si trajnerë dhe lehtësues në bashkitë e Tiranës, Pogradecit, Krujës, Fushë-Krujës dhe komunës së Buçimasit.

Aftësitë Komunikuese dhe Përfshirëse

Për të përmirësuar aftësitë komunikuese dhe përfshirëse të nëpunësve të bashkive, një program trainimi për Aftësitë Komunikuese dhe Përfshirëse për nëpunësit e bashkive u zhvillua me pjesëmarrjen e 12 nëpunësve të informimit publik nga bashkitë e Pogradecit, Tiranës, Korçës, Fierit, Rrëshenit, Kuçovës, Elbasanit, dhe Peshkopisë. Si rezultat, pjesëmarrësit zhvilluan planet e tyre të veprimit për të përmirësuar aftësitë komunikuese dhe përfshirëse në bashkitë përkatëse.

Aftësitë e Manaxhimit të Konfliktit

Për të ndërtuar praktika bashkëpunuese efektive ndërmjet pushtetit vendor dhe qytetarëve, PSh hartoi dhe zhvilloi trainime për Aftësitë e Manaxhimit të Konfliktit për nëpunësit e pushtetit vendor. Trainimi mundësoi pjesëmarrësit të kuptonin shkaqet e konfliktit dhe të përmirësonin aftësitë e tyre në lidhje me

sjelljen dhe trajtimin e situatave konfliktuale. Si pjesë e këtij programi, PSh trajnoi 26 nëpunës të bashkive të Krujës dhe Fushë-Krujës.

Transparenca dhe Përgjegjshmëria e Pushtetit Vendor


Duke filluar që në Janar të vitit 2004, Partnerët - Shqipëri filloi zbatimin e një programi të ri duke u fokusuar në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së pushtetit vendor. Programi asistoi stafin e bashkive në zhvillimin e sistemeve financiare të hapura dhe transparente dhe përmirësimin e sjelljes profesionale nëpërmjet prezantimit të kodit të etikës për pushtetin vendor në Shqipëri.

Bashkitë që morën pjesë në program ishin Fushë-Krujë, Krujë, Pogradec, Fier, Kuçovë, Elbasan, Shkodër, Durrës dhe Vlorë. Në vazhdim të programit të trainimit, PSh do të ofrojë 1-2 ditë asistencë teknike në fushat që kanë lidhje me temat e dhëna, bazuar në nevojat e identifikuara.

Disa prej shëmbujve të rezultateve nga programet e ndryshme të Ndërtimit të Kapaciteteve të Pushtetit Vendor përfshijnë:

- 392 nëpunës bashkish u trainuan në çështje të ndryshme të forcimit të kapaciteteve dhe të transparencës.
- Programi i Partnerëve-Shqipëri asistoi 10 bashki në Shqipëri (Durrës, Elbasan, Fier, Krujë, Fushë-Krujë, Kuçovë, Pogradec, Shkodër, Tiranë, Vlorë) për të përmbushur më mirë nevojat e qytetarëve nëpërmjet përmirësimit të aftësive manaxhuese dhe drejtuese.
- 9 prej bashkive të asistuara kanë zhvilluar plane veprimi për të krijuar dhe/ose përmirësuar Kodin e tyre të Etikës.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të pjesëmarrësve në programet e trainimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Pushtetit Vendor.



NUMRI I PJESMARRËSVE NË TRAINIM
SIPAS RAJONEVE GJEOGRAFIKE

III. FUQIZIMI I LIDERSHIPIT DHE AFTESIVE BASHKEPUNUESE TE QYTETAREVE SHQIPTARE

Partnerët - Shqipëri zhvilluan disa programe strategjike të hartuara për të fuqizuar dhe zgjeruar pjesëmarrjen e qytetarëve në tërë shoqërinë shqiptare, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë komuniteteve jashtë kryeqytetit. Nëpërmjet punës së saj me OJF-të dhe autoritetet bashkiake si dhe vlerësimin të nevojave të shoqërisë civile, Partnerët-Shqipëri zhvilluan programe për grupe specifike duke përfshirë gratë, liderat e rinj dhe studentët.

A. Zhvillimi i LiderShipit të Gruas

Partnerët-Shqipëri beson se gratë janë një forcë e rëndësishme për ndryshim në shoqëritë në tranzicion, sidomos nëpërmjet zhvillimit të liderShipit të tyre në shoqërinë civile. Megjithatë, gratë vuajnë nga një përfaqësim i ulët në pozicionet drejtuese në qeverisje, biznes, media dhe sektorë të tjerë. Partnerët - Shqipëri mbështet zhvillimin e rolit të liderShipit të gruas duke ndërtuar aftësi dhe asistuar krijimin e rrjetëzimeve ndërmjet grave, duke mundësuar ato që të mbrojnë në mënyrë efektive të drejtat dhe nevojat e tyre duke kontribuar në të njëjtën kohë edhe në zhvillimin e vendit.

Në kuadër të Programit të LiderShipit të Gruas, Partnerët - Shqipëri lehtësoi krijimin e një rrjeti ku bërthamën e përbën një grup prej 18 grash që do të promovojnë komunikimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre në të gjithë vendin. Ky program synon të zhvillojë aftësitë e liderShipit, komunikimit dhe organizimit të grave dhe grupeve të grave nëpërmjet trainimit dhe zbatimit të iniciativave vendore që adresojnë çështje të grave.

Programi i LiderShipit të Gruas konsistoi në trainime mbi:

- Ciklin e Manaxhimit të Projektit
- Komunikim dhe Manaxhim Konflikti
- LiderShip dhe Manaxhim
- Marrja në Mbrojtje e Politikave dhe Rrjetëzimi
- Aftësi Trainimi

Duke përdorur aftësitë e fituara nga programi, 18 gratë lidere zbatuan një seri iniciativash lokale, duke përfshirë:

- Organizimi i takimeve publike në bashkitë e Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës (me pjesëmarrjen e 250 grave) për të informuar gratë rreth Kodit të Ri të Familjes.
- Edukimi i votuesve në bashkitë e Fierit, Vlorës dhe Pogradecit, rreth grave që do të kandidojnë për zgjedhjet lokale, nëpërmjet mbledhjeve publike, diskutimeve të transmetuara nga televizionet lokale dhe publikimeve për marrëdhëniet me publikun.
- Nxitja e një klime paqësore të marrëdhënieve multi-entike në Jug të Shqipërisë duke drejtuar një grup diskutimesh ndërmjet organizatave të ndryshme për gratë, pushtetit vendor dhe institucioneve fetare.
- Identifikimi i nevojave për zhvillim dhe shërbime për gratë në zonat rurale në veri të vendit, për t'iu ardhur në ndihmë organizatave për zhvillim që punojnë në këto zona të përcaktojnë strategjitë e tyre të veprimit nëpërmjet trainimeve dhe skemave të mikro-kredive.
- Trainimi i grave mbi aftësitë drejtuese dhe manaxhuese: pjesëmarrësit e Programit të PSh për LiderShipin e Grave arritën në total një numër prej 340 grash.

B. Zhvillimi i Lidershipit të Rinisë

Rinia është një forcë vitale në zhvillimin demokratik të vendit. Me qëllim përgatitjen e profesionistëve të rinj nga OJF-të, qeveria vendore dhe qendrore, si dhe biznesi për të përmbushur potencialin e tyre udhëheqës si dhe për të mundësuar ata që të bashkëveprojnë në situatat multipartiake që kërkojnë zhvillimet sociale, Partnerët - Shqipëri ka hartuar një "paketë" trainimi.

Si pjesë e këtij programi, Partnerët - Shqipëri ka trainuar 150 profesionistë të rinj nga OJF-të, qeveria vendore dhe qendrore, biznesi dhe sektorë të tjerë mbi disa çështje për të nxitur rolet e tyre drejtuese. Programi përfshiu trainime në:

- Lidership dhe Manaxhim
- Manaxhimi i Konfliktit dhe Ndryshimit
- Komunikimi Efektiv
- Negocimi
- Ndërtimi i Ekipit
- Lehtësimi
- Marrëdhëniet me Publikun
- Marrja në Mbrojtje e Politikave
- Manaxhimi i Projekteve

Gjithashtu, Partnerët - Shqipëri zhvilluan aftësitë trainuese të një grupi prej 50 pjesëmarrësish më aktivë në program për të promovuar ndryshime pozitive në komunitetet e tyre. Ata u asistuan nga stafi i PSh për të zhvilluar dhe zbatuar iniciativat lokale që adresojnë çështjet e të rinjve në zonat e tyre, si përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet grupeve të ndryshme etnike, rritja e aksesit për njerëzit me aftësi të kufizuara në insitucionet publike dhe nxitja e bashkëveprimet ndërmjet grupeve të të rinjve dhe OJF-ve. Disa nga iniciativat përfshijnë:

- "Më pranë leximit" projekt që synon të përmirësojë sistemin e bibliotekës së shkollës së mesme "Ismail Qemali" në Tiranë nëpërmjet instalimit të një programi kompjuterik për bibliotekat dhe financimit të blerjes së librave të rinj.
- Projekti "Integrim, Emancipim dhe Mirëqënie", i organizuar për ditën Ndërkombëtare të Romëve në Durrës më pjesëmarrjen e të rinjve të moshave 15-22 vjeçare, që përfaqësonin grupe të ndryshme minoritetesh sic janë romët, egjiptianët dhe fëmijë e pastrehë. Projekti nëpërmjet një shfaqjeje artistike synoi të promovonte tolerancë dhe mirëkuptim ndërmjet grupeve minoritare dhe pjesës tjetër të popullsisë.
- "Një Verë e Gëzueshme për Fëmijët e Rrugës", synon të integrojë fëmijët e rrugës në jetën shoqërore nëpërmjet organizimit të aktiviteteve sociale, sportive dhe zbavitëse për KoPShtin e Fëmijëve -Tirana, Qendrës DELFI XS dhe drejtuar nga Shoqata e Grave të Reja Kristiane.
- "Të Rinjtë, Forcë Vitale në Proçeset Demokratike", synon nxitjen e aktivizmit të të rinjve në proçeset demokratike nëpërmjet organizimit të një "Panairi të OJF-ve Rinore" ku do të shpërndahen informacionet më të fundit mbi politikën dhe projektet rinore, vullnetarizmit dhe mundësi të tjera përfshirjeje për të rinjtë e interesuar.

D. Programi Akademik

Që në fillimet e krijimit të tij në 1989, rrjeti i Partnerëve ka promovuar zhvillimin e kurseve teorike dhe praktike për ndryshimin dhe manaxhimin e konfliktit brenda institucioneve kryesore arsimore në vendet me demokraci në tranzicion dhe në kushtet e ekonomisë së tregut. Rrjeti i Partnerëve ka organizuar seminare akademike nëpërmjet Qendrave të tij në Argjentinë, Bullgari, Republikën Çeke, Hungari, Lituani, Poloni, Rumani dhe Sllovaki. Si rezultat, mbi 50 kurse bëjnë pjesë aktualisht në kurrikulën e universiteteve kryesore të këtyre vendeve.

Bazuar në mangësitë e identifikuara në kurrikulat e universiteteve në Shqipëri si dhe në eksperiencën e rrjetit ndërkombëtar të Partnerëve, Partnerët – Shqipëri zhvilluan një program për përfshirjen e praktikës së ndryshimit dhe manaxhimit të konfliktit në kurrikulën e Universitetit të Tiranës. Programi filloi me trainimin e një grupi pedagogësh nga Fakulteti i Shkencave Sociale. Trainimet paraqitën metodologjitë e manaxhimit të ndryshimit dhe konfliktit si dhe siguruan mbështetje të më vonshme në hartimin e kurrikulës së re.

Objektivat e seminarit përfshinin:

- Zhvillimin e teorisë dhe praktikës së metodologjive të ndryshimit dhe konfliktit në shoqërinë shqiptare.
- Nxitjen e zhvillimit të teorive të reja dhe përshtatjen e teorive aktuale me realitetin vendas.
- Ndërtimin e marrëdhënieve të reja ndërmjet grupeve akademike të disiplinave të ndryshme, duke mundësuar studime kërkimore në një varietet disiplinash.

Seminari akademik konsistoi në:

- Seminar 4 ditor mbi zgjidhjen e konfliktit i drejtuar nga një ekspert në zhvillimin e kurrikulës së zgjidhjes së konfliktit. Në seminar morën pjesë nëntë pedagogë nga Fakulteti i Shkencave Sociale që përfaqësonin Departamentet e Punës Sociale, Psikologjisë dhe Pedagogjisë, Sociologjisë dhe Filozofisë.
- Materiale të detajuara mbi bazat themelore të zgjidhjes së konfliktit dhe manaxhimit të ndryshimit, si dhe akses në materialet më të fundit.
- Asistencë individuale për zhvillimin e kurseve, duke përfshirë programin mësimor dhe listë librash.
- Një prezantim të teknikave pedagogjike më bashkëkohore.
- Simulime novatore dhe shembuj ushtrimesh për pedagogët që të mund t'i përdorin në orët e tyre të leksioneve.

Si rezultat i iniciativës, pjesëmarrësit në program prezantuan në vitin akademik 2002 – 2003 një kurs mbi Manaxhimin e Konfliktit për studentët e vitit të dytë të Fakultetit të Shkencave Sociale, si dhe një seri leksionesh dhe seminaresh mbi Manaxhimin e Konfliktit në fusha të tjera studimi.

D. Iniciativat e Planifikimit Kooperues

Planifikimi kooperues është një metodologji e manaxhimit të ndryshimit, i cili mbledh së bashku interesa apo aktorë të ndryshëm në një proces të lehtësuar për të ndërtuar një qëndrim konsensual ndaj një çështje të caktuar. Planifikimi

kooperues është një mjet i dobishëm për të adresuar një varg çështjesh si rregullimet infrastrukturore, çështje të strehimit, ruajtjes së mjedisit, zhvillimit ekonomik, taksat, marrëdhëniet polici – komunitet.

Partnerët - Shqipëri lehtëson procese të planifikimit kooperues në komunitete, duke asistuar tërë grupet e interesit në një komunitet në punën e tyre për të ndërtuar konsensus dhe gjetur zgjidhje për probleme me të cilat ballafaqohen.

